



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT / MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Referencë:	Numër: 02-191/16
Për/Za/To:	Qytetarët e Komunës së Junikut
Nga/Od/From:	z. Faik Tofaj - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Datë/Datum/Date:	22.01.2016
Tema/Subjekat/Subject:	NJOFTIM

Në bazë të nenit 43 paragrafi 43.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 30.6 të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** shpall:

NJOFTIM PUBLIK

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së rregullt (e njëzetekatërta) të Kuvendit të Komunës së Junikut.

Data e mbajtjes së mbledhjes: 29.01.2016;

Vendi i mbajtjes së mbledhjes: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;

Koha e mbajtjes së mbledhjes: 10⁰⁰;

Rendi i ditës së mbledhjes:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Nxjerrja e vendimit për datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i (projekt) Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2016;
4. Nxjerrja e vendimit për fillimin e hartimit të (projekt) Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i (projekt) Planit për mobilitet të qëndrueshëm urban në komunën e Junikut (lexim i parë);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i (projekt) Planit për mirëmbajtje të hapësirave të hapura publike në qytetin e Junikut (lexim i parë); dhe
7. Të ndryshme.

